



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.99/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtarin ligjor Albert Haliti, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit B.U.B.I me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kadri Osaj Avokat në Mitrovicë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur, me datë 13.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpapia e paditësit B.U.B.I me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kadri Osaj Avokat në Mitrovicë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr. 295/2020, i datës 02.10.2020, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B.U.B.I me seli në Mitrovicë me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 11.11.2020, të plotësuar me parashtrësën e datës 14.12.2020, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.295/2020, të datës 02.10.2020 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke propozuar që të aprovohet papia e paditësit, të anulohet vendimi i ATK-së nr.295/2020, të datës 02.10.2020, dhe paditësi të lirohet në tersi nga pagesa për të cilën pretendon e paditura ATK-ë. Në

seancën e shqyrtimit gjyqësor -kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se:. Konsideroj se në këtë çështje tatimore klienti im padrejtësisht është vlerësua me tatim shtesë nga ana e inspektorit tatimor ngase klienti im nuk ka pasur të hyra ashtu që të mund të llogariten të hyrat shtesë pra nuk e ka kaluar pragun për të hyrë në TVSH, klienti im është fakt që e ka pasur një kontabilist të angazhuar i cili është marrë me çështje profesionale dhe të njëjtit klienti im ja ka falur besimin, ne qoftë se kontabilisti e ka futur padrejtësisht klientin tim në TVSH atëherë i njëjti mbahet përgjegjës për këtë, dhe ne qoftë se me te vërtete inspektori i ka gjetur këto te dhëna prapë këto duhet ti adresohen kontabilistit për faktin se klienti im vitin 2019 ka pasur të hyra operuese 18,073.22 Euro, në vitin 2018 ka pasur të hyra operuese 13,009.21 Euro në vitin 2017 13,710.21 në asnjë prej këtyre viteve nuk është kaluar pragu i TVSH-së edhe klienti im e ka kuptuar rrethanën që ka qenë i futur në TVSH vetëm pasi që është bërë kontrolli nga ATK, askund nga Raporti i Kontrollit nuk shkruhet se klienti im ka dhënë pëlqim paraprak për tu futur në TVSH. Konsideroj se e gjithë kjo rrethanë është një keqkuptim nga ana e ATK-së dhe nga ana e kontabilistit nuk janë pasqyruar të dhënat e sakta në raport me ATK-në. Andaj kërkoj nga gjykata të veprohet sipas padisë dhe plotësimit të saj të dt. 14.12.2020 ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, të anulohet vendimi kontestues 295/2020 i dt. 02.10.2020 dhe lënda të kthehet edhe një herë në rishqyrtim – rivendosje tek e paditura ATK ashtu që e njëjta ta vlerësoj çështjen në mënyre te drejte pasi që në asnjë nga periudhat tatimore sipas Raportit të Kontrollit nuk është tejkaluar pragu për tu futur në TVSH. Vlerat operuese qe i prezantova paraprakisht janë vlera që dalin nga Raporti i Kontrollit, klienti im ka shitur për I... mbushje te telefonit dhe internetit dhe nga kjo kompani ka marrë provizionin dhe nga këto provizione janë nxjerre vlerat operuese nga ana e inspektorit, problemi qëndron se TVSH-ja nga kontabilisti B.Y.është llogaritur si qarkullim i këtu paditësit gabimisht ngase ky qarkullim i takon I...s dhe jo tatimpaguesit tutje tatimpaguesi është dashur te ngarkohet vetëm me qarkullim mbi bazën e vlerave operues te nxjerra nga provizionet. Nga provat e administruara pran kësaj seanca te shqyrtimin gjyqësor kryesor e konkretisht nga rezultatet e nxjerra nga Raporti i Kontrollit i vet ATK-së është konstatuar se te hyrat operuese te cilat kane rrjedhur nga provizioni për tre vitet kontestuese për te cilat është bere inspektimi nuk e kane kaluar pragun e TVSH-së andaj caktimi i tatimit të

TVSH-së ne te hyrat operuese nga provizioni nuk është konform legjislacionit ne fuqi dhe është një ngarkese e pa drejte ndaj paditësit- tatimpaguesit e cila ngarkese e ka sjelle në vështirësi financiar ngase paditësi- tatimpaguesi nuk munde te operoj me llogaritë e tija bankare ngase te njëjta janë te bllokuara nga ATK, ashtu qe e kane sjelle paditësin ne kolaps financiar. Deklarimi i pretenduar qe vullnetarisht ka hyre ne TVSH është i pa qëndrueshëm ngase nuk e shpreh vullnetin e paditësit- tatimpaguesit, andaj ne baze te lart cekurave gjykatës i propozoj qe ta aprovoj padinë si te bazuar, ta anuloj vendimi kontestues te atakuar dhe lenden ta kthej ne rivlerësim tek e paditura ngase ky vlerësim nuk eshët bere konform gjendjen faktike dhe legjislacionit ne fuqi. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 16.07.2021, ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së nr. 295/2020, i datës 02.10.2020, është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, duke propozuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazë, dhe vërtetohet vendimi i DA të ATK-së nr. 295/2020 i datës 02.10.2020 i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor -kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe sqarimeve të cilat janë dhënë në lidhje më pikat kontestuese, të gjitha sqarimet lidhur me këtë rast janë dhënë ne mënyrë te detajuar ne vendimin kontestues 295/2020 si dhe në përgjigjen në padi e dt.16.07.2021, sa i përket pretendimit se tatimpaguesi nuk e ka kaluar pragun e TVSH-se për periudhat tatimore kontestuese ATK-ja sqaron se bazuar ne nenin 6 të ligjit 05/L-037 për TVSH par.1 nder te tjera parashihet, çdo person qe i përmbush te gjitha kushtet e përkufizimit mbi personin e tatueshëm te referuar ne nenin 4 te këtij ligji, kërkohet te regjistrohet për TVSH, nëse brenda viti kalendarik tejkalon qarkullimin prej 30.000 Euro, ATK e sqaron gjykatën se nga analizimi i gjendjes se përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve te tjera te tatim paguesit ne sistemin e ATK-se SIGTAS, ATK ka konstatuar se paditësi-tatimpaguesi qe nga viti 2014 është deklarues i TVSH-se dhe për te gjitha periudhat kontrolluese 2017, 2018, 2019 ka te tejkalar qarkullimin prej 30.000 Euro, dhe e njoftojmë gjykatën se për te qene deklarues i TVSH-se momentin e regjistrimit ne

certifikatën e TVSH-se duhet me qene nënshkrimi i pronarit te tatimpaguesit, ku ne rastin konkret tatimpaguesi veprimtarinë e ka të regjistruar si biznes individual. Lidhur me pretendimet se janë keqpërdorur këto te dhëna nga ana e kontabilisti i këtu paditësit atëherë ekziston një procedure tjetër qe këtu paditësi ka mundur ta ndjek nga viti 2014. Kontesti i tatim paguesit për ngarkesën me TVSH sipas plotësim padisë të cilën e kemi pranuar nga gjykata të pa protokolluar ka qene ne vlerën 6,885.03 Euro lidhur me shitjen e produkteve te I...s si interes i fituar dhe e cila sipas pretendimeve te tatimpaguesit ne padi – ankese me shkrim është vlerësim jo i drejte nga ATK, ATK pas analizimit te dosjes se dispozitave ligjore qe rregullojnë çështjen ne fjale ka vërtetuar se kontrolli tatimor ka vlerësuar drejte ne rastin konkret, këtë konstatim ATK e mbështet bazuar ne marrëveshjen e tatimpaguesit me I..., ku për rishitjen e produkteve te I... tatimpaguesi pranon një provizion nga 5 deri ne 7% te hyra këto te pa deklaruar si shitje nga paditësi ne kundërshtim me dispozitat ligjore konkretisht nenin 15 UA 03/15 par.5. nen par.5.2, andaj konsiderojmë se ne rastin konkret ATK ka vepruar ne përputhshmëri me legjislacionin tatimor dhe ne momentin e kontrollit ky tatim pagues ka qene deklarues vullnetar i TVSH-së fakt i cili vërehet shume çartë edhe te prova e ofruar ne përgjigjen ne padi. ATK e njofton gjykatën se ky tatimpagues është ngarkuar sa i përket shitjeve te cilat nuk i ka deklaruar siç e obligon legjislacioni tatimor. ATK ne momentin e kontrollit e ka pare ne sistem qe ky tatimpagues është deklarues i TVSH-së dhe për pjesën e qarkullimit shtese nga provizioni- fitimi sipas marrëveshjes me I... e ka ngarkuar me TVSH siç e kërkon legjislacioni tatimor andaj mbesim ne tërësi pran përgjigje ne padi, sqarimeve te dhëna ne këtë seance dhe njëherit kërkojmë nga gjykata qe pas shqyrtimit te provave te merre aktgjykim ku refuzohet kërkesë padia e paditësit si e pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i ATK-së nr.295/2020 i dt. 02.10.2020. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 13.02.2023, ka administruar provat dhe atë: Vendimi 295/2020 i dt.02.10.2020, vendimi 212/2020 i dt 16.06.2020; Njoftim Vlerësimi i dt.18.06.2020; Ankesa e ushtruar në ATK e dt.11.09.2020; Inicimi i procedurës për ndëshkimin–gjobitjen nr.212/2020 dt.12.06.2020; Raporti i Kontrollit

nr.2370/05.06.2020; Përgjigja në padi e dt.16.07.2021; Format AU 001, AU 002 dhe AU 003; Intervista fillestare e dt.19.02.2020; Libri i shitjeve për vitin 2017, 2018 dhe 2019; Kartela e I...S për tatimpaguesin për blerjet 2017-2019 së bashku me tabelën e provizioneve; Qarkullimet për llogarit bankare nga banka N... për vitet 2017, 2018 dhe 2019 nga banka T... për vitet 2017, 2018 dhe 2019; Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera e dt së printimit 13.07.2021 e nxjerrë nga sistemi SIGTAS në ATK.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Raporti i Kontrollit, deklarimeve në ankesë, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, përgjigja në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se tek subjekti në procedurë është bërë kontrolli për periudhën kontrolluese për TVSH-ë 01/2017-12/2019, Tatimi në të Ardhurat Personale (PD) për periudhën 2017-2018, Kontributet Pensionale të Pronarit (CI) për periudhën TM1/2017-TM4/2018. Pas kontrollit përfundimtarë rezultojnë ndryshimet, (TVSH) për periudhën 2017-2019 ka rezultuar me zvogëlim të balancës kreditore në vlerë prej 897,19 Euro, dhe tatim shtesë në vlerë prej 6,885.03 Euro, (PD) për vitin 2017-2018 me tatim shtesë në vlerë 414.90 Euro, (CI) ka rezultuar me tatim shtesë në vlerë 895.00 Euro. Po ashtu, nuk është kontestuese as fakti se subjekti në procedurë ka ushtruar ankesë tek e paditura Administrata Tatimore të Kosovës, e cila ka marrë vendimin nr.295/2020 të dt.02.10.2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar të njëjtën, e ndaj të cilit vendim paditësi me padinë e datës 11.11.2020, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave - të ATK-së, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e subjektit tatimor, këtu paditësit lidhur me ndëshkimin tatimor në vlerë prej 125.00 euro, ndërsa pjesët tjera të vlerësimit kanë mbetur të pa ndryshuara.

Gjykata vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit se në këtë çështje tatimore klienti im padrejhtësisht është vlerësua me tatim shtesë nga ana e inspektorit tatimor ngase klienti im nuk ka pasur të hyra ashtu që të mund të llogariten të hyrat shtesë pra nuk e ka kaluar pragun për të hyrë në TVSH, për faktin se klienti im vitin 2019 ka pasur të hyra operuese 18,073.22 Euro, në vitin 2018 ka pasur të hyra operuese 13,009.21 Euro në vitin 2017 13,710.21 në asnjë prej këtyre viteve nuk është kaluar pragu i TVSH-së edhe klienti im e ka kuptuar rrethanën që ka qenë i futur në TVSH vetëm pasi që është bërë kontrolli nga ATK-ë, kjo për faktin se çdo person që i përmbush të gjitha kushtet e përkufizimit mbi personin e tatueshëm të referuar në nenin 4 të ligjit 05/L-037 për TVSH-ë, kërkohet të regjistrohet për TVSH, nëse brenda viti kalendarik tejkalon qarkullimin prej 30.000 Euro, dhe gjykata nga analizimi i gjendjes së përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve të tjera të tatimpaguesit këtu paditësit në sistemin e ATK-se SIGTAS, të datës së printimit 13.07.2021, ka konstatuar se paditësi - tatimpaguesi që nga viti 2014 është deklarues i TVSH-se dhe për të gjitha periudhat kontrolluese 2017, 2018, 2019 ka tejkalluar qarkullimin prej 30.000 Euro.

Tutje nuk qëndron as pretendimi tjetër i paditësit dhe atë lidhur me faktin se këtu paditësi ka shitur për I...-n mbushje të telefonit dhe internetit dhe nga kjo kompani ka marrë provizionin dhe nga këto provizione janë nxjerre vlerat operuese nga ana e inspektorit, problemi qëndron se TVSH-ja nga kontabilisti B.Y. është llogaritur si qarkullim i këtu paditësit gabimisht ngase ky qarkullim i takon I...-s dhe jo tatimpaguesit këtu paditësit, tutje tatimpaguesi është dashur të ngarkohet vetëm me qarkullim mbi bazën e vlerave operues të nxjerra nga provizionet, kjo për faktin se raporti i kontrollit të ATK-së është bazuar në marrëveshjen e tatimpaguesit me I..., ku për rishitjen e produkteve të I...-s ka vlerësuar se tatimpaguesi këtu paditësi pranon një provizion nga 5 deri në 7%, të hyra këto të pa deklaruara si shitje nga paditësi në kundërshtim me dispozitat ligjore

konkretisht nenin 15, par.5. nen par.5.2, të Udhëzimit Administrativ 03/2015 dhe në rastin konkret ATK-ja e ka ngarkuar vetëm me vlerën 6,885.03 Euro lidhur me shitjen e produkteve të L...-s si interes i fituar nga kjo kompani.

Duke mare për bazë faktin se gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1, të LKA-se, nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar-administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike gjykata vlerëson se vendimi nr.295/2020, i datës 02.10.2020 i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.99/2022 datë 13.02.2023

Zyrtar Ligjor  
Albert HALITI

\_\_\_\_\_

Gj y q t a r i  
Fisnik NULI

\_\_\_\_\_

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate